



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE PRIZREN/ OSNOVNI SUD U PRIZRENU/ BASIC COURT IN PRIZREN

Cnr.105/06

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN në përbërje nga gjyqtari Shaban Shala, me sekretaren juridike Luljeta Susuri, si procesmbajtëse, në çështjen juridike të paditësit Komuna e Prizrenit, të cilin e përfaqëson i autorizuari Avokati Publik Komunal B. M. , kundër të paditurit S. K. nga Prizreni, Rr. N. K. pa numër, lidhur me borxhin, vlera e kontestit 1.016 €, pas mbajtjes së seancës kryesore publike, në prezencën e të autorizuarit të paditësit, e në mungesë të paditurit, me datën 27.11.2013, mori këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadija e paditësit Komuna e Prizrenit, ashtu që i padituri S. K. nga Prizreni, **obligohet** të paguaj borxhin në shumën prej 1.016,25 € në emër të shfrytëzimit të hapësirës publike sipas kontratës nr. ../..-...-... të datës 26.05.2005, dhe atë për muajt korrik, gusht dhe shtator të vitit 2005 gjegjësisht për 92 ditë, e cila hapësirë publike gjendet para lokalit DPH "E." në rrugën Sh. i L. pa numër e cila paraqet pronë shoqërore të paditësit me kamatë ligjore prej 3.5 % nga dita e parashtrimit të padisë (09.02.2006) deri në plotfuqishmërinë e tij nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

Me shpenzime procedurale obligohet i padituri.

A r s y e t i m

Paditësi në këtë gjykatë ka paraqitur padi me të cilën ka kërkuar që i padituri të paguaj borxhin sipas kontratës në shumën prej 1.016,25 €, me kamatë ligjore prej 3,5 % në emër të shfrytëzimit të hapësirës publike. Në shqyrtimin kryesor të datës 27.11.2013 përfaqësuesi i autorizuar i paditësit ka mbetur në tërësi si në padi dhe kërkesëpadi, duke i propozuar gjykatës që pas administrimit të provave të obligoj të

paditurin që të paguaj borxhin në shumën prej 1.016,25 € me kamatë ligjore prej 3.5 % nga dita e parashtrimit të padisë gjerë në pagimin definitiv, ndërsa nuk i ka kërkuar shpenzimet procedurale.

Shqyrtimi kryesor është mbajtur në mungesë të paditurit të thirrur në mënyrë të rregullt i cili mungesën nuk e ka arsyetuar, në kuptim të nenit 423 par 4 të LPK.

Gjykata në shqyrtimin kryesor më qëllim të konstatimit të plotë dhe të drejt të gjendjes faktike ka administruar këto prova: ka bërë leximin e kërkesës të paditurit të datës 22.04.2005, ka bërë leximin e procesverbalit të datës 12.05.2005, ka bërë leximin e kontratës për shfrytëzimin e përkohshëm të hapësirës publike të datës 26.05.2005, ka bërë shikimin në faturën e paditësit të datës 26.05.2005, ka bërë leximin e aktvendimit të datës 20.07.2005, ka bërë shikimin në faturat e të paditurit të datës 04.06.2005 dhe 20.07.2005, ka bërë shikimin në faturën të datës 02.08.2005 dhe ka bërë leximin e vërejtjes para padisë të datës 10.10.2005 dhe pas vlerësimit të këtyre provave në kuptim të nenit 8 të LPK-së, ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit pasi ka vërtetuar gjendjen faktike si më poshtë:

Nga leximi i kërkesës të paditurit të datës 22.04.2005, gjykata e vërteton faktin se i padituri me kërkesën e tij i është drejtuar Drejtoratit për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor që ti lëshohet leja për vendosjen e tavolinave para lokalit DPH "E." Rr. Sh. i L. pa numër në Prizren.

Nga leximi i procesverbalit të datës 12.05.2005, gjykata e vërteton faktin se i padituri para lokalit "E." ka vendosur 21 tavolina dhe karriga dhe se duhet të vijë në këtë organ – Drejtoratin për Urbanizëm konkretisht në zyrën .. , në afat prej 2 (dy) ditësh për të lidhur kontratën për vendosjen e tavolinave dhe karrigave.

Nga leximi i kontratës për shfrytëzimin e përkohshëm të hapësirës publike të datës 26.05.2005, gjykata e vërteton faktin se palët ndërgjyqëse kanë lidhur kontratë për shfrytëzimin e përkohshëm të hapësirës publike konkretisht për vendosjen e tavolinave dhe karrigave para lokalit të paditurit DPH "E." në sipërfaqe prej 44,175 m². Kjo kontratë është lidhur në kohë të caktuar dhe atë nga data 01.04.2005 deri në 30.09.2005 (gjatë sezonës verore).

Nga shikimi në faturën e paditësit të datës 26.05.2005, gjykata e vërteton faktin se i padituri obligohet që të paguaj këstin e parë për muajt prill, maj dhe qershor të vitit në shumën prej 1.004,98 €.

Nga leximi i aktvendimit të datës 20.07.2005, gjykata po ashtu vërteton faktin se të paditurit i lejohet vendosja e 15 tavolinave para lokalit DPH "E." në sipërfaqe prej

44,175 m² dhe për periudhën 01.04.2005 deri më 30.06.2005 ka paguar borgjin në shumën prej 1004,98 €.

Nga shikimi në faturat e të paditurit të datës 04.06.2005 dhe 20.07.2005, gjykata e vërteton faktin se i padituri lidhur me obligimin sipas aktvendimit ../.-...-... ka paguar me datën 04.06.2005 shumën prej 500 €, ndërsa me datën 20.07.2005 shumën 504.98 €.

Nga shikimi në faturën të datës 02.08.2005 gjykata e vërteton faktin se i padituri i obligohet paditësit për këstin e dytë për muajt korrik, gusht dhe shtator të vitit 2005 shumën prej 1.016,25 € dhe

Nga leximi i vërejtjes para padisë të datës 10.10.2005 gjykata njoftohet me kërkesën e paditësit që i padituri të paguaj borxhin për këstin e dytë sipas aktvendimit ../.-...-... në shumën prej 1.016,25 € në të kundërtën do ti drejtohen gjykatës për realizimin e borxhit.

Për gjykatën nuk është kontestues fakti se i padituri ka shfrytëzuar hapësirën publike para lokalit të tij DPH "E." i cili gjendet në Rr. Sh. i L. në Prizren, dhe atë në sipërfaqe prej 44,175 €, ku çmimi për 1 m² ka qenë i caktuar në shumën prej 0.25 €, dhe se i padituri është obliguar që borgjin e tij ta paguaj në dy këste, këstin e parë në shumën prej 1.004,98 € i cili përfshin muajt prill, maj dhe qershor të vitit 2005 ndërsa këstin e dytë në shumën prej 1.016,25 € i cili përfshin muajt korrik, gusht dhe shtator të vitit 2005. Kjo gjendje faktike vërtetohet nga të gjitha provat të cilat janë administruar në këtë shqyrtim kryesor.

Mirëpo mbetet kontestues fakti se i padituri për shfrytëzimin e hapësirës publike e cila i është lejuar në bazë të aktvendimit të Organit të paditësit dhe obligimet të cilat i ka marrë në bazë të kontratës për shfrytëzimin e hapësirës publike a i ka kryer në tërësi. Nga provat e administruara posaçërisht nga fatura e datës 04.06.2005 dhe fatura e datës 20.07.2005 gjykata e vërteton faktin se i padituri, paditësit në llogarinë e tij në "R." B. ia ka kryer obligimin lidhur me këstin e parë i cili përfshin muajt prill, maj dhe qershor të vitit 2005, të cilave prova gjykata ia falë besimin. Ndërsa duke pasur për bazë faktin se ka prova (kontrata dhe fatura e datës 02.08.2005) se i padituri obligohet që ti paguaj borgjin paditësit edhe për këstin e dytë në shumën e kërkuar sipas padisë, ndërsa në shkresat e lëndës nuk ka prova respektivisht i padituri nuk ka ofruar dëshmi me anë të cilave do të vërtetohej se e ka kryer obligimin apo në ndonjë bazë tjetër është liruar nga ky obligim gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke e obliguar të paditurin që të paguaj borxhin me kamata ligjore prej 3.5 % ma kamata ligjore nga dita e parashtrimit të padisë deri në pagimin definitiv.

Duke u bazuar në këtë gjendje faktike gjykata e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 17 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve i cili përcakton: "**Pjesëmarrësit e marrëdhënies së detyrimit kanë për detyrë ta zbatojnë detyrimin e vetë dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tij**" pasi që është vërtetuar se i padituri ka shfrytëzuar hapësirën publike para lokalit të tij dhe për muajt korrik, gusht dhe shtator të vitit 2005 nuk ka paguar çiran.

Obligohet i padituri që ti mbarti shpenzimet procedurale sado që të jenë ato, konform nenit 452 të LPK.

Nga arsyerat e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

Cnr.105/06 të dt.27.11.2013

Sekretarja juridike

Luljeta Susuri

Gjyqtari

Shaban Shala

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur mund të ushtrojë ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 dite nga dita e pranimit, ankesa dorëzohet nëpërmjet të kësaj gjykate.